

Titulli i lëndës: HYRJE NË LETËRSINË GJERMANE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë: Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë gjermane
Titulli i lëndës:	Hyrje në letërsinë gjermane
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti I, semestri I
Numri i orëve në javë:	3 + 1
Kreditë ECTS:	7 ECTS
Koha / Vendi:	Salla 32, sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Naim Kryeziu
Të dhënat kontaktuese:	naim.kryeziu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda “Hyrje në letërsinë gjermane” trajton letërsinë e krijuar në Gjermani, por përfshin edhe letërsinë e krijuar në Austri dhe në pjesën gjermanishtfolëse të Zvicrës, si dhe hedh një vështrim në epoka të ndryshme të kësaj letërsie, duke u nisur nga mesjeta e hershme gjer në ditët tona.
Qëllimet e lëndës:	Lënda “Hyrje në letërsinë gjermane” synon që studenti: <ul style="list-style-type: none">• të njihet me konceptet, me sfondin historik, me karakteristikat, me përfaqësuesit kryesorë të letërsisë gjermane, si edhe:• me vepra të zgjedhura,• me format e krijimtarisë letrare të epokave përkatëse, të japë një përmbledhje të shkurtër të historisë së letërsisë gjermane.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas mbarimit të kursit, studenti duhet të ketë njohuri të mjaftueshme:

- për fillesat e letërsisë gjermane (*mesjeta e hershme dhe mesjeta e vonë*);
- për epokën e barokut (bazat dhe format e krijimtarisë letrare: *lirika, epika dhe dramatika*);
- për iluminizmin (bazat, filozofia e Lesingut për teatrin dhe format e krijimtarisë letrare: *dramat e Lesingut*);
- për rrymën „*Stuhi dhe vrull*“ (bazat, format e krijimtarisë letrare: *dramaturgjia, epika dhe lirika*);
- për klasicizmin (bazat dhe format e krijimtarisë letrare: *lirika dhe teoria e praktika e dramës*);
- për romantizmin (bazat dhe format e krijimtarisë letrare: *lirika, novela, përralla artistike dhe përralla e dramatizuar*);
- për Paramarsin dhe Bidermajerin (bazat dhe format e krijimtarisë letrare: *lirika dhe dramat e Byhnerit*);
- për realizmin, për natyralizmin dhe për ekspresionizmin (bazat dhe format e krijimtarisë letrare: *epika dhe sidomos dramaturgjia e lirika*);
- për letërsinë e Republikës së Vajmarit (bazat dhe format e krijimtarisë letrare: *epika*. Temë e veçantë: Tomas Man – *“Budenbrokët”*);
- për Rajhun e Tretë dhe për emigracionin: *Letërsia në fashizëm*; për letërsinë bashkëkohore (format e krijimtarisë letrare: *epika dhe dramaturgjia*. Temë e veçantë: *Koncepti i Dyrrenmatit për teatrin*).

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1	15	15
Punë praktike	2	5	10
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	4	3	12
Përgatitje për biseda interaktive në lidhje me leksionet e zhvilluara	3	2	6
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	5	2	10
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë ose në shtëpi)	6	3	18

Përgatitja për provimin përfundimtar	2 (90 min)	15	30
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi përfundimtar)	3 (60 min)	1	3
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
Total			150:25= 6 ETCS
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi zhvillohet me ligjërata dhe me ushtrime. Gjatë ushtrimeve zbatohet metoda ndërvepruese. Ushtrimet bëhen sipas temave dhe detyrave të caktuara. Ushtrimet zhvillohen në grupe e në çifte, por edhe në mënyrë individuale. Studentët janë të detyruar të bëjnë punime seminari dhe të lexojnë vepra të zgjedhura letrare. Pas paraqitjes së punimeve të seminarit dhe të leximit të veprave letrare zhvillohet edhe debat.		
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja aktive dhe detyrat 20 % • Testi i parë 30 % • Provimi përfundimtar (me shkrim/me gojë) 50% 		
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. J.B. Metzler Verlag, Stuttgart - Weimar, 1994: DEUTSCHE LITERATURGESCHICHTE <i>Von den Anfängen bis zur Gegenwart</i> 2. Diether Krywalski, München: Droemer Knaur 1992: <i>Knaus Lexikon der Weltliteratur</i> Gerhard Lauer: <i>Germanistik UNI-WISSEN</i>, Klett: Lernen und Wissen GmbH, Stuttgart 2008 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Klett: Lernen und Wissen GmbH, Stuttgart 2010 - DEUTSCH, <i>Literaturgeschichte, Epochen</i> 		

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjërates
Java 1:	Fillesat e letërsisë gjermane: Temë e veçantë: “ <i>Kënga e Hildebrandit</i> ” dhe “ <i>Kënga e Nibelungëve</i> ” e zanafilla e saj.
Java 2:	Baroku: Bazat, format e krijimtarisë letrare: <i>Lirika</i> . Temë e veçantë: <i>Analizë krahasimtare e dy soneteve tipike të stilit barok dhe forma të krijimtarisë letrare: Epika dhe dramatika</i> .
Java 3:	Iluminizmi: Bazat dhe temë e veçantë: <i>Immanuel Kant</i> . Përgjigje pyetjes: Ç’është iluminizmi? Filozofia e Lesingut për teatrin. Forma të krijimtarisë letrare: <i>dramat e Lesingut</i> . Temë e veçantë: <i>Lesingu dhe “Natani i urtë”</i> .
Java 4:	“Stuhi dhe vrull”: Bazat, format e krijimtarisë letrare: <i>Dramaturgjia, epika dhe lirika</i> .
Java 5:	Klasicismi: Bazat dhe format e krijimtarisë letrare: <i>lirika, teoria dhe praktika e dramës</i> .
Java 6:	Klasicismi: Temë e veçantë: <i>Karakterit patetik i heroit të Shileri</i> . <i>Format e krijimtarisë letrare: Dramat e Shilerit dhe të Gëtes</i> .

Java 7:	Klasicismi: Temë e veçantë: <i>Gëte – “Fausti”</i> . <i>Format e krijimtarisë letrare: epika e Klajstit.</i>
Java 8:	Romantizmi: Bazat dhe format e krijimtarisë letrare: <i>lirika, novela, përralla artistike dhe përralla e dramaturgjisë</i> . Temë e veçantë: <i>Lirika: mungesa në dukje e artit si teknikë letrare.</i>
Java 9:	Paramarsi dhe Bidermajeri: Bazat dhe format e krijimtarisë letrare: <i>Lirika dhe dramaturgjisë e Byhnerit.</i>
Java 10:	Realizmi, natyralizmi dhe ekspresionizmi: Bazat dhe format e krijimtarisë letrare: <i>lirika.</i>
Java 11:	Realizmi, natyralizmi dhe ekspresionizmi: Temë e veçantë: Fonten: <i>“Elfi Brist” - Epërsia e konvencioneve shoqërore.</i> Format e krijimtarisë letrare: <i>dramaturgjisë.</i> Format e krijimtarisë letrare: <i>lirika.</i>
Java 12:	Letërsia në Republikën e Vajmarit: Bazat dhe dramaturgjisë. Format e krijimtarisë letrare: <i>epika.</i>
Java 13:	Letërsia në Republikën e Vajmarit. Temë e veçantë: Tomas Man: <i>“Budenbrokët”</i> .
Java 14:	Rajhu i Tretë dhe emigracioni: <i>Letërsia në fashizëm.</i>
Java 15:	Letërsia pas 1945 dhe Letërsia bashkëkohore: Format e krijimtarisë letrare: <i>epika dhe dramaturgjisë.</i> Temë e veçantë: <i>Koncepti i Dyrrenmatit për teatrin.</i>

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët duhet të vijnë me kohë në auditor, sepse ardhja me vonesë sjell ndërprerjen e mësimit dhe pengon, çrregullon e shpërqendron vëmendjen e studentëve. Gjatë orës së mësimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike, sepse shkaktojnë zhurmë ose pengesa të tjera.

Hartoi: Prof. dr. Naim Kryeziu /04.04.2025/NKr